

SALI KADRIA

ZHVILLIMET BRENDA NACIONALIZMIT SHQIPTAR NË VITET 1920-1921*

Në këtë trajtesë do të përqendrohemi në zhvillimin politik të nacionalizmit shqiptar, duke u fokusuar kryesisht në dy aspekte kryesore:

1. Zhvillimet politike brenda Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”;

2. Raportet e drejtuesve të Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” me grupet e tjera nacionaliste shqiptare gjatë periudhës historike të marrë në studim.

Në vitet 1920-1921, nacionalizmi shqiptar njohu një rritje cilësore. Mirëpo, edhe gjatë kësaj periudhe nuk munguan vështirësitë, problemet dhe mosmarrëveshjet në mesin e nacionalistëve, të cilat u nxitën sa nga ndërhyrja e faktorit të jashtëm, po aq edhe nga divergjencat personale, krahinore, fetare si dhe nga rivaliteti politik.

Në fund të vitit 1919 dhe në fillim të vitit 1920, filluan të tensionoheshin marrëdhëniet ndërmjet drejtuesve të Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”. Acarimi i marrëdhënieve në mesin e përfaqësuesve të krahut të nacionalizmit irredentist u kushtëzua edhe nga situata e rëndë politike në të cilën ndodhej çështja shqiptare. Në këtë periudhë, mbetej e hapur çështja, nëse lufta e shqiptarëve duhej të drejtohej kundër shteteve fqinje, apo pushtuesve italianë. Hasan Prishtina, Bajram Curri e të tjerë mendonin se bashkimi i Kosovës me Shqipërinë nuk mund të realizohej pa ndihmën e Italisë. Meqenëse Italia kishte kontradikta dhe interesa të kundërta me Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene, ata shpreheshin se shqiptarët duhej ta shfrytëzonin atë në dobi të çështjes kombëtare. Në të njëjtën kohë, këta përfaqësues dyshonin se

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore “Komiteti ‘Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës’ dhe koha e tij”, Tiranë, 2 maj 2018, organizuar nga Instituti i Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike - Tiranë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë dhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup.

pas nënshkrimit të marrëveshjes Tittoni-Venizellos, drejtuesit e “Krahit Kombëtar” me origjinë kryesisht nga Shqipëria e Jugut, po nxisnin shqiptarët të ngriheshin në luftë kundër Italisë, pasi ata synonin të shpëtonin vetëm Vlorën dhe viset e Shqipërisë së Jugut.¹

Pavarësisht prirjes së një pjese të drejtuesve të “Komitetit të Kosovës” për t’u orientuar drejt Italisë, deri në këtë periudhë, ata nuk i kërkuan mbështetje kësaj fuqie, sepse druhen se në shkëmbim, ajo do të kërkonte aneksimin e Vlorës, ndërkohë që Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene do të kërkonte aneksimin e Shkodrës dhe të gjithë Shqipërisë së Veriut deri në lumin Mat, ndërsa Greqia do të kërkonte Shqipërinë e Jugut.²

Në acarimin e marrëdhënieve mes Hasan Prishtinës dhe Rexhep Mitrovicës ndikuan këndvështrimet e ndryshme politike të tyre, e cila u shoqërua me një retorikë të ashpër. Rexhep Mitrovica deklaroi se Hasan Prishtina në bashkëpunim me Ali Shefqet Shkupin, kishin formuar në Tiranë, një grup me emrin “Pshtimi [Shpëtimi] i Shqipnis”, i cili ishte duke përçarë “Komitetin e Kosovës”. Sipas tij, grupi i Tiranës nën drejtimin e Hasan Prishtinës, po vepronte kundër degës së “Komitetit të Kosovës” në Durrës.³ Për rrjedhojë, në radhët e krahit të nacionalizmit irredentist shqiptar u krijuan dy grupe: “Grupi i të rinjve” i drejtuar nga Rexhep Mitrovica dhe grupi i drejtuar nga Hasan Prishtina.

Grupi i të rinjve të degës së “Komitetit të Kosovës” në Durrës, si: Rexhep Mitrovica, Halim e Sadik Gostivari filluan të bashkëpunonin me organizatën “Krahu Kombëtar”, por në të njëjtën kohë, ata nuk i shkëputën lidhjet me Mustafa Krujën, një nga drejtuesit kryesorë të

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 243, Viti (më tej: V.) 1919, Dosja (më tej: D.) 28/4, fl. 49-55. Letër e Hoxhë Kadriut drejtuar Hasan Prishtinës, 22 shtator 1919.

² *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920* (përmbledhje dokumentesh), përgatitur nga Muin Çami dhe Hidajete Luga (Bejtja) në bashkëpunim me Dhimitër Andonin, Mediha Shuteriqin dhe Zekeria Rexhën, vëll. I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1975, dok. nr. 219, f. 331-335. Letër e drejtuesve të Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, Hoxha Kadri, Bedri Pejani, Sali Nivica dhe Bajram Fevziu drejtuar një personi të pidentifikuar, Shkodër, 27 gusht 1919.

³ *Po aty*, F. 35, V. 1919, D. 36/5, fl. 1167-1177. Letër e Rexhep Mitrovicës, drejtuar Mid’hat Frashërit, Paris, 17 tetor 1919; *po aty*, F. 35, V. 1919, D. 34/5, fl. 5-6. Letër e Rexhep Mitrovicës, drejtuar Mid’hat Frashërit, Paris, 20 tetor 1919.

qeverisë së Durrësit.⁴ Për shkak të bashkëpunimit të tyre politik me “Krahun Kombëtar”, Hasan Prishtina e cilësoi grupin e të rinjve kosovarë, si “axhami” [të papjekur] në politikë, si dhe u shpreh se Rexhep Mitrovica po “mundohej ma shumë për Gjinokastrën, e ma pak për Kosovën”.⁵ Rexhep Mitrovica akuzoi Hasan Prishtinën se po nxiste përçarjen e shqiptarëve, “duke marrë nëpër gojë Toskë e Gegë me një gjuhë të ndytë”.⁶ Hasan Prishtina hodhi poshtë këtë akuzë, me argumentin se për të, “ç’ka janë gegët, po ata janë toskët”. Ai u shpreh se Rexhep Mitrovica sulmonte drejtuesit e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, për faktin se ai e dinte se Hoxhë Kadri Prishtina dhe Hasan Prishtina kishin ndikim në Shqipërinë e Veriut.⁷

Rexhep Mitrovica kritikoi edhe Hoxhë Kadri Prishtinën, që mbante detyrën e kryetarit të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” se, ai kishte rënë në ujdë me Hasan Prishtinën dhe nuk po zbatonte statutin e kësaj organizate. Hoxhë Kadriu u shpreh se ai nuk kishte asnjë marrëveshje me Hasan Prishtinën. Madje, ai kritikoi Rexhep Mitrovicën se kishte formuar degën e “Komitetit të Kosovës” në Durrës, pa marrë mendimin e drejtuesve të kësaj organizate.⁸

Me propozimin e drejtuesve të “Krahut Kombëtar”, përfaqësuesit e “Komitetit të Kosovës” Hysni Curri, Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Halim e Sadik Gostivari dhe Sali Vuçiterni zhvilluan një takim me Mustafa Krujën në Durrës.⁹ Në fund të takimit, të dyja palët nënshkruan një marrëveshje të fshehtë, e cila në vija të përgjithshme pati këtë përmbajtje: 1. Mbajtjen e një kongresi tjetër kombëtar, në të cilin drejtuesit e qeverisë së Durrësit të raportonin mbi veprimtarinë e saj; 2.

⁴ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942, (Kujtime dhe vlerësime historike)*, përgatitur për botim nga Maranglen Verli, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 173.

⁵ *AQSH*, F. 35, V. 1920, D. 36/5, fl. 1179. Letër e Rexhep Mitrovicës, drejtuar Mid’hat Frashërit, 15 gusht 1920; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 197.

⁶ *AQSH*, F. 446, V. 1919, D. 3, fl. 23. Letër e Rexhep Mitrovicës drejtuar Hoxhë Kadriut, 22 dhjetor 1919.

⁷ *Hasan Prishtina – Përmbledhje dokumentesh 1908-1934*, përgatitur nga Kujtim Nuro dhe Nezir Bata, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, dok. nr. 61, f. 103-105. Letër e Hasan Prishtinës drejtuar [Rakip Kaja Begollit?], nënkryetar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 9 tetor 1919.

⁸ *AQSH*, F. 446, V. 1920, D. 4, fl. 7-19. Letër e Hoxhë Kadriut drejtuar Rexhep Mitrovicës, 5 janar 1920.

⁹ Mustafa Kruja – P. Paulin Margjokaj OFM, *Letërkëmbim (1947-1958)*, Shkodër: Camaj-Pipa, 2006, dok. nr. 53, f. 199-200.

Zëvendësimin e kësaj qeverie me një qeveri tjetër; 3. Propozimin e emrit të Nexhip Dragës në kongres, si kandidaturë për postin e kryeministrit të qeverisë së re; 4. Qëndrimin e Mustafa Krujës në qeverinë e përkohshme të Durrësit, për aq kohë sa prania e tij do të shihej e nevojshme për çështjen kombëtare; 5. Mustafa Kruja duhej të përpiquej të çrrënjoste veprimtarinë “esadiste” në Shqipërinë e Mesme, si dhe t’i bindte autoritetet italiane, që të mos kundërshtonin mbajtjen e kongresit kombëtar; 6. Në prag të kongresit, Mustafa Kruja, duhej të nxiste kolegët e qeverisë së Durrësit që të dorëzonin mandatin kongresit, në të kundërt, duhej të jepte dorëheqjen e tij.¹⁰

Nga kjo marrëveshje, duket se më i fituar doli Mustafa Kruja, i cili arriti t’i bindë përfaqësuesit e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare të Kosovës”, që Kongresi Kombëtar të mbahej më 10 janar 1920, në qytetin e Krujës, ku ai kishte ndikim. Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” ngarkoi Rexhep Mitrovicën, Hysni Currin dhe Xhemal Prishtinën për të marrë pjesë në këtë kongres. Hoxhë Kadriu dhe Bedri Pejani njoftonin se “Komiteti i Kosovës” ishte lidhur me këtë lëvizje dhe se ata kishin besimin se “përfundimi i tij ka për t’i vu një kapak krejt apatisë së Shqipërisë së Londrës”.¹¹

Drejtuesit e “Krahut Kombëtar” mendonin se Mustafa Kruja ishte duke bërë lojën e italianëve. Për këtë arsye, ata ndërmorën dy hapa të rëndësishëm politikë. *Së pari*, ata vendosën organizimin e Kongresit Kombëtar në Lushnjë më 21 janar 1920, duke braktisur marrëveshjen e fshehtë të arritur nga Hysni Curri, Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Halim e Sadik Gostivari dhe Sali Vuçiterni me Mustafa Krujën për organizimin e kongresit në Krujë. Sejfi Vllamasi shprehet se “meqenëse midis dy palëve mungonte besimi dhe sinqeriteti, marrëveshja në fjalë u prish vetëvetiu”.¹² *Së dyti*, drejtuesit e “Krahut Kombëtar” hynë në bisedime me

¹⁰ *Po aty*, dok. nr. 53, f. 202.

¹¹ *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920* (përmbledhje dokumentesh), përgatitur nga Muin Çami dhe Hidajete Luga (Bejtja) në bashkëpunim me Dhimitër Andonin, Mediha Shuteriqin dhe Zekeria Rexhën, vëll. II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1976, dok. nr. 3, f. 14. Letër e kryetarit dhe sekretarit të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, drejtuar nënprefekturës së Malësisë së Gjakovës në Krasniqe, Shkodër, 3 janar 1920; *po aty*, dok. nr. 4, f. 15-16. Thirrje e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” drejtuar krerëve të malësive, për forcimin e besës së lidhur për mbrojtjen e atdheut, Shkodër, 6 janar 1920.

¹² S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 173.

mbështetësit e Esat Pashë Toptanit, meqenëse të dyja palët e shihnin “Qeverinë e Durrësit të shitur tek italianët”. Ahmet Zogu i bëri të ditur Mustafa Krujës se ishte ftuar nga Eshref Frashëri për të marrë pjesë në një kongres tjetër. Mustafa Kruja akuzonte Eshref Frashërin për “tradhti”, pasi në vend të bashkëpunimit me të, preferoi të lidhej me Esat Pashë Toptanin.¹³

Në fillim të janarit 1920, Hoxhë Kadriu deklaroi se, qeveria e Durrësit “nuk ishte e interesuar të merrej me zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme të shqiptarëve. Populli ishte mërzitë, prandaj kishte ardhur koha që të rrëzohej kjo qeveri e të zëvendësohej me një tjetër”.¹⁴ Rexhep Mitrovica njoftoi Hoxhë Kadriun që “Komiteti i Kosovës” duhej të dërgonte përfaqësuesit e tij në Kongresin e Lushnjës, pasi për arsye familjare do të nisej për në Vjenë.¹⁵ Drejtuesit e “Komitetit të Kosovës” ngarkuan Hysni Currin dhe Xhemal Prishtinën që të përfaqësonin shqiptarët e Kosovës në Kongresin e Lushnjës. Mirëpo, Mustafa Kruja e bindi Hysni Currin që të ndryshonte drejtim dhe të shkonte në Krujë.¹⁶

Xhemal Prishtina kërkonte ta shtynte nisjen e tij për në Lushnjë me argumente të tilla, se nuk njihte programin e Kongresit të Lushnjës dhe se nuk dihej se çfarë do të përfitonte Kosova nga ky kongres. Ai shprehej se përderisa qarkullonin fjalë se qeveria e Durrësit do të pengonte mbajtjen e këtij kongresi, do të ishte më mirë të priste, derisa të merrte vesh se edhe delegatët e tjerë ishin nisur për në Lushnjë.¹⁷

Hoxhë Kadriu njoftonte Xhemal Prishtinën se delegacioni i Komitetit Mbrojtja Kombëtare duhej të merrte pjesë në Kongresin e Lushnjës për një sërë arsyesh. Ai akuzonte qeverinë e Durrësit se kishte mbajtur një qëndrim indiferent ndaj çështjes së Kosovës, kur dihej se aty jetonin më tepër se 900 mijë bashkëkombës. Qeveria e Durrësit kishte lejuar pa bërë asnjë lloj rezistence, pushtimin nga trupat serbe të gjithë Shqipërisë së Veriut deri në brigjet e lumit Drin, ndonëse ky territor ishte njohur si pjesë e Shqipërisë politike. Kjo qeveri nuk kishte marrë asnjë

¹³ Letër e Mustafa Krujës për Stavro Skëndin, Ramleh, (Egjipt), 2 nëntor 1953, në *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Tiranë: 1996, f. 116-119 .

¹⁴ Fane Veizi, *Kongresi i Lushnjes*, Tiranë: Mihal Duri, 1959, f. 29.

¹⁵ *AQSH*, F. 446, V. 1920, D. 16, fl. 51-53. Letër e Rexhep Mitrovicës drejtuar Hoxhë Kadriut, kryetar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, Durrës, 7 janar 1920.

¹⁶ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 184.

¹⁷ *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920...*, vëll. II, dok. nr. 10, f. 21-22. Letër e Xhemal Prishtinës drejtuar [Hoxhë Kadriut ?], Durrës, 11 janar 1920.

masë për shpëtimin e shqiptarëve nga Plava, Gucia dhe Rugova, të cilët u larguan nga vendi i tyre për të shpëtuar nga masakrat serbe në shkurt të vitit 1919. Për më tepër, ajo i kishte lënë ata në mëshirën e fatit, në kënetat e Bushatit dhe të Barbullushit, ku nga sëmundja e malaries vdiqën rreth 300 shqiptarë. Për arsyet e mësipërme, Hoxhë Kadriu shprehej në favor të rrëzimit të qeverisë së Durrësit.

Drejtuesi i “Komitetit të Kosovës” udhëzonte delegatët kosovarë që në emër të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” t’i parashtronin Kongresit të Lushnjës këto çështje: 1. Kongresi duhej të protestonte para Fuqive të Antantës, kundër mizorive serbe ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë; 2. Delegacioni shqiptar në Paris të kërkonte një Shqipëri plotësisht të pavarur si dhe bashkimin me shtetin shqiptar të krahinave të Kosovës, Manastirit, Çamërisë dhe Ulqinit; 3. Zëvendësimin e Luigj Gurakuqit dhe at Gjergj Fishtës me delegatë të tjerë, pasi ata nuk ishin zgjedhur nga Kongresi i Durrësit më 1918; 4. Qeveria e Durrësit të rrëzohej dhe të zëvendësohej me një kabinet tjetër të besueshëm.¹⁸

Pavarësisht udhëzimeve të Hoxhë Kadriut, delegatët e Kosovës e zvarritën pjesëmarrjen e tyre në Kongresin e Lushnjës. Hysni Curri justifikohet se vonesa e tyre ishte kushtëzuar nga njoftimi që kishte marrë nga Sotir Peci se pas vrasjes së Abdyl Ypit, ishte pezulluar përkohësisht mbajtja e Kongresit të Lushnjës. Gjithashtu, ai ishte informuar se qeveria e Durrësit kishte vendosur të mos lejonte përfaqësuesit e Lezhës që të shkonin në Lushnjë.¹⁹

Ali Shefqeti i kërkoi Hoxhë Kadriut që t’i shkruante Hysni Currit që të mos binte në lakun e mashtrimeve të Mustafa Krujës, por të nisej sa më parë për në Lushnjë. Ai sqaronte se vonesa e delegatëve të Kosovës dhe të Shkodrës vinte për shkak të intrigave të qeverisë italiane.²⁰ Edhe Bedri Pejani i shkruante Hysni Currit se Kongresi i Lushnjës ishte një mbledhje me karakter kombëtar, në të cilin merrnin pjesë delegatë nga e gjithë Shqipëria me përjashtim të Krujës. B. Pejani i kërkonte Hysni

¹⁸ *AQSH*, F. 446, V. 1920, D. 16, fl. 13. Letër e drejtuesve të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” për delegacionin e tij në Kongresin e Lushnjës, Shkodër, 18 janar 1920.

¹⁹ *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920...*, vëll. II, dok. nr. 29, f. 42-43. Letër e Hysni Currit për drejtuesit të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, Lezhë, 20 janar 1920.

²⁰ *Po aty*, dok. nr. 44, f. 56. Letër e Ali Shefqetit drejtuar [Hoxhë Kadriut?], Tiranë, 29 janar 1920.

Currit që grupi i përfaqësuesve të Kosovës duhej të nisej menjëherë për në Lushnjë. Ai e porosiste atë se në këtë periudhë kaq të vështirë për fatin e atdheut, duhej “me i lanë me një anë mendimet personale e me ecë bashkarisht me krejt Shqipninë”.²¹

Bajram Fevziu i shkruante Hoxhë Kadriut se “na ka dëshpëruar së tepërmi bashkëpunimi i Hysni Beut me Mustafa Krujën”. Madje, ai kërkonte të informohej sa më parë nga “Komiteti i Kosovës” se “deri ku kishte arritur në këtë çështje, tradhtia e të lartpërmendurit”.²² Në këto kushte, gazeta “Populli” u përpoq të justifikonte para publikut qëndrimin e Hysni Currit me argumentin se “ai ishte nisur për Lushnjë, por qëndroi në Krujë për me i ba ballë çdo rreziku që mund të shkrepë nga Veriu ose Jugu...”²³

Meqenëse “Komiteti i Kosovës” rrezikonte të mos përfaqësohej në Kongresin Kombëtar, Hoxhë Kadriu vendosi të nisej vetë për në Lushnjë së bashku me delegatët e Shkodrës Sabri Bej Bushati, Xhemal Bej Bushati, Mati Logoreci dhe Ndoc Çoba. Por, këta delegatë arritën të bashkoheshin me kongresistët, pas përfundimit të punimeve të Kongresit.²⁴

Si vlerësim ndaj kontributit të dhënë nga “Komiteti i Kosovës”, një prej organizatave nacionaliste më aktive brenda vendit, Kongresi i Lushnjës vendosi që Hoxhë Kadriu të zgjidhej ministër i Drejtësisë në qeverinë e Sulejman Delvinës. Me orientimin e “Komitetit të Kosovës”, popullsia e Malësisë së Gjakovës, e cila gjendej nën pushtimin jugosllav i shkruante qeverisë shqiptare: “Na, populli i Malësisë së Gjakovës, tuj e pasë vendin tonë brenda kufinit politik të Shqipnisë... jemi të gatshëm të ngrejmë flamurin e Shqipnisë dhe me ba organizimin hapun. Prandaj, ju lutemi të keni mirësinë të na dërgoni një orë e ma parë nënprefektin e Malësisë, z. Niman Feriz Gjakovën me gjithë programin e organizimit shqiptar”.²⁵

²¹ *Po aty*, dok. nr. 57, f. 71. Letër e Bedri Pejani, sekretar i Komitetit “Mbrotja Kombëtare e Kosovës”, drejtuar Hysni Currit në Krujë, Shkodër, 1 shkurt 1920.

²² *Po aty*, dok. nr. 75, f. 100. Letër e Bajram Fevziut drejtuar Hoxha Kadriut, Shkodër, 14 shkurt 1920.

²³ “Korrespondencë nga Tirana”, në *Populli*, Viti II, nr. 53, Shkodër, 6 shkurt 1920, f. 3.

²⁴ *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920...*, vëll. II, dok. nr. 80, f. 108. Raport i komandantit të trupave aleate në Shkodër, gjeneralit francez Bardi dë Furtu, drejtuar eprorëve të tij, Shkodër, 16 shkurt 1920.

²⁵ *Po aty*, dok. nr. 111, f. 148. Letër e përfaqësuesve të Malësisë së Gjakovës drejtuar Kryeministrit, 10 mars 1920.

Ministri i Drejtësisë Hoxhë Kadriu në bashkëpunim me Ahmet Zogun, i cili mbante detyrën e ministrit të Punëve të Brendshme, hartuan programin e veprimit, për bashkimin e qytetit të Shkodrës me qeverinë e Tiranës.²⁶ Të dy ministrat u takuan me anëtarë të “Komitetit të Kosovës” në Bushat të Shkodrës. Meqenëse, trupat franceze nuk lejonin hyrjen e forcave të armatosura shqiptare në Shkodër, përfaqësuesit e qeverisë shqiptare hynë në Shkodër dhe u kërkuan qytetarëve të Shkodrës të armatoseshin dhe të qëndronin në gadishmëri në pritje të ndonjë sulmi malazez.

Gjatë vitit 1920, mosmarrëveshjet dhe rivaliteti politik ndërmjet nacionalistëve shqiptarë mbetën të pranishme. Rryma “proitaliane” e përfaqësuar nga Mustafa Kruja, Myfit Bej Libohova, e të tjerë, mbeti e pakënaqur. Të gjithë veprimtarinë e grupit të “Krahut Kombëtar”, kjo rrymë e konsideronte thjesht një “luftë për karrige”. At Gjergj Fishta shprehej se një grup shqiptarësh hodhën poshtë formulën “Shqipëria me ndihmën e Italisë”, por ata nuk arritën të gjenin një formulë tjetër politike që t’i zinte vendin së parës. Ai shprehej se “të thuash se ne do ta formojmë Shqipërinë vetëm me forcat tona, është në mos tjetër, një marrëzi”.²⁷

Mustafa Kruja kaloi nga diskursi politik në veprime të armatosura kundër qeverisë së Tiranës. Në prill të vitit 1920, Mustafa Kruja hyri në bisedime me Ymer Efendinë, kryetar i një komiteti lokal të formuar në krahinën e Dibrës, i cili punonte për interesat e Esat Pashë Toptanit. Qëllimi i bisedimeve ishte organizimi i një aksioni të përbashkët kundër qeverisë së Tiranës.²⁸ Ndërkohë, qeveria shqiptare mblodhi forcat e xhandarmërisë dhe nën komandën e Bajram Currit shpartalloi forcat “esadiste” në Shqipërinë e Mesme.²⁹

Disa muaj pas mbajtjes së Kongresit të Lushnjës, në mesin e nacionalizmit shqiptar u shfaqën shenjat e përçarjes. Krisja e unitetit politik shqiptar nisi në organizatën e “Krahut Kombëtar” apo “Klikës” [kjo organizatë politike filloi të quhej me këtë emër nga kundërshtarët politikë - S.K.] nga ana e Aqif Pashë Elbasanit, i cili ndërhynte në

²⁶ *Po aty*, dok. nr. 116, f. 152. Program veprimi për bashkimin administrativ të qytetit të Shkodrës me qeverinë e Tiranës, [mars 1920].

²⁷ *Po aty*, dok. nr. 165, f. 214. Letër e Gjergj Fishtës drejtuar Vinçens Prenushit, Paris, 15 prill 1920.

²⁸ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 197.

²⁹ *Po aty*, f. 198.

kompetencat e ministrit të Punëve të Brendshme Ahmet Zogu. Meqenëse kjo organizatë i dha mbështetje Ahmet Zogut, Aqif Pashë Elbasani u largua nga “Klika”. Përçarja u thellua më tej, me shfaqjen e mosmarrëveshjeve midis Hoxhë Kadriut me Kryeministrin Sulejman Delvina.³⁰ Pakënaqësia e tij u shtua më shumë, kur mësoi se Sejfi Vllamasi ishte dërguar nga qeveria shqiptare për bisedime të fshehta në Beograd. Në këto rrethana, në fillim të muajit maj 1920, Hoxhë Kadriu paraqiti dorëheqjen e tij nga detyra.³¹ Hoxhë Kadriu vendosi të ndërpriste bashkëpunimin me “Krahun Kombëtar”, duke kaluar në kampin kundërshtar.

Një pjesë e nacionalistëve shqiptarë me në krye Sulejman Delvinën, Ahmet Zogun dhe Qazim Koculin dolën në mbështetje të fillimit të luftës kundër trupave italiane në Vlorë.³² Hoxhë Kadriu e disa të tjerë dolën kundër, me argumentin se lufta kundër italianëve, mund t’i kushtonte shtrenjtë popullit të Vlorës dhe qeverisë shqiptare. Ajo mund t’i krijonte mundësi Greqisë që të përfitonte nga situata dhe të pushtonte Gjirokastrën. Gjithashtu, nëse Italia do të tërhiqte trupat e saj nga Shkodra, forcat jugosllave mund të pushtonin Shkodrën. Me krijimin e një situatë të tillë, kundërshtarët politikë mund të nxisnin popullin për të përmbysur qeverinë.³³

Edhe drejtuesit e Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” me në krye Hasan Prishtinën synonin fillimin e një kryengritjeje tjetër kundër pushtimit jugosllav. Anëtarët e delegacionit shqiptar në Paris, Luigj Bumçi dhe Mihal Turtulli, i kërkuan anëtarit të Këshillit të Naltë, Aqif Pashës që shqiptarët të mos përfshiheshin në konflikt me qeverinë jugosllave, “ashtu si kërkon të bajë z. Hasan bej Prishtina, pse jugosllavët mund të kuptohen me italianët mbi kurrizin tonë, e na nuk jemi të zotët t’i bajmë luftë gjithë botës”.³⁴

³⁰ *Po aty*, f. 188.

³¹ *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920...*, vëll. II, dok. nr. 224 f. 266. Letër e Hoxha Kadriut ministër i Drejtësisë, drejtuar Këshillit të Lartë, Tiranë, 11 maj 1920.

³² S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 220.

³³ *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920...*, vëll. II, dok. nr. 296, f. 350. Letër e Hoxha Kadriut drejtuar një personi të pidentifikuar, 12 qershor 1920.

³⁴ *Po aty*, dok. nr. 140, f. 181. Pjesë nga letra e L. Bumçit dhe M. Turtullit nga Parisi, dërguar kryetarit të Këshillit të Lartë, Aqif Pashës, Paris, 1 prill 1920.

Faik Konica dhe Sejfi Vllamasi kritikuan qëndrimin e Ramiz Dibrës, Elez Isufit, Ramiz Dacit dhe Jashar Erebarës për fillimin në gusht 1920, të luftës kundër trupave jugosllave në krahinën e Dibrës. Ata shpreheshin se forcat e drejtuara nga prefekti i sapoemëruar Ramiz Dibra, sulmuan pa asnjë lloj provokimi, postat e trupave serbe, duke u futur disa kilometra në brendësi të territorit të shtetit jugosllav. Mirëpo, pas kundërsulmit të shpejtë të trupave jugosllave, forcat shqiptare pësuan humbje. Dështimi i këtij aksioni, u shoqërua me vrasje, djegie dhe masakra të trupave jugosllave ndaj popullsisë civile shqiptare. Pasojat e humbjes ishin të mëdha për shqiptarët: 7 500 shtëpi u dogjën, 23 mijë banorë të Dibrës dhe krahinës së Mbishkodrës u detyruan të largoheshin nga vatrat e tyre. Shpenzimet e qeverisë shqiptare për të përballuar gjendjen e krijuar arritën në miliona franga ari.³⁵ Situata e rëndë e krijuar, mund të nxiste popullsinë e pashpresë që t'i kundërvihet qeverisë shqiptare.³⁶

Përvoja e nxjerrë nga kryengritja e Dibrës i detyroi drejtuesit e qeverisë shqiptare që të kundërshtonin me forcë shkarkimin e vaporit me armë e municione që u dërguan nga D'Annunzio për fillimin e një kryengritjeje të re nga ana e shqiptarëve të Kosovës me në krye Hasan Prishtinën. Qeveria shqiptare e konsideroi këtë lëvizje, si veprim të gabuar, pasi ajo mund të vinte në rrezik fatin e Shqipërisë.³⁷

Në vjeshtë të vitit 1920, grupimi i nacionalistëve të krahut irredentist të Kosovës u nda në dy grupe: Grupi i parë, përbëhej nga të rinj intelektualë, si: Rexhep Mitrovica, Beqir Vokshi, Halim Gostivari, Bedri Pejani, Hadush Kastrati, Ibrahim Jakova dhe Osman Tetova. Ky grupim vendosi një bashkëpunim të ngushtë me grupin e "Klikës". Grupi i dytë, përbëhej nga përfaqësuesit e periudhës së Rilindjes Kombëtare, si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Qerim Begolli dhe Xhemal Prishtina. Grupi i Hasan Prishtinës u bashkua me grupin "proitalian", duke shtuar radhët e kundërshtarëve të qeverisë së Tiranës.³⁸

Ky grupim i bashkuar kishte për qëllim rrëzimin e qeverisë së Tiranës dhe vendosjen në pushtet të një qeverie tjetër italofile, e cila do të ndihmonte për çlirimin e Kosovës nga sundimi serb. Grupi i Hasan

³⁵ AQSH, F. 35, V. 1920, Kutia 3, D. 36/4, fl. 913. Letër e Mihal Turtullit, drejtuar Mid'hat Frashërit, Tiranë, 25 nëntor 1920.

³⁶ *Po aty*, F. 14, V. 1920, Kutia 7, D. 108, fl. 1. Letër e Faik Konicës, drejtuar Fan Nolit, Romë, 19 gusht 1920.

³⁷ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 221-223.

³⁸ *Po aty*, f. 189.

Prishtinës, Bajram Currit dhe Ferhat Dragës, të ndihmuar edhe nga disa anëtarë të “Krahut Kombëtar” filluan një luftë të ashpër kundër Ahmet Zogut, i cili ishte në atë kohë “kolona vertebrale e qeverisë”. Sipas përfaqësuesve të këtij grupi, shumica e mbështetësve të Ahmet Zogut në “Krahun Kombëtar”, nuk interesoheshin për çlirimin e Kosovës.³⁹

Në pranverë të vitit 1921, mosmarrëveshjet në mesin e nacionalizmit shqiptar u thelluan për shkak të zgjedhjeve për deputetë në prefekturën e Drinit. Ato nuk u zhvilluan në mënyrë të rregullt për shkak se ishte e vështirë të përcaktohej nëse shumica e popullsisë së dëbuar nga masakrat e ushtrisë serbe ishte zhvendosur në pjesën përtej lumit Drin në brendësi të Shqipërisë apo vazhdonte të qëndronte në veri të këtij lumi.⁴⁰

Deputetët e Shkodrës u propozuan deputetëve të prefekturës së Drinit, formimin e një grupi të përbashkët, në mënyrë që të përfitonin në maksimum, duke u bërë arbitër i parlamentit. Ky mendim u hodh poshtë nga Rexhep Mitrovica, Maliq Bushati dhe Kol Thaçi.⁴¹ Pas një hezitimi të gjatë, me ftesën e Bajram Currit u zhvillua një mbledhje në shtëpinë e tij në të cilën ai kërkoi që të vendosej se me cilën parti do të bashkoheshin. Drejtuesit e grupit L. Gurakuqi, Gj. Fishta dhe M. Kruja vendosën për t’u bashkuar me “Partinë Përparimtare” nën drejtimin e Hoxhë Kadriut. Ndërsa, Rexhep Mitrovica e Mehdi Bushati vendosën të bëheshin pjesë e “Partisë Popullore”.⁴²

Pas problemeve që shkaktoi “Kryengritja e Mirditës” dhe ndërhyrja e trupave jugosllave në brendësi të Shqipërisë gjatë vitit 1921, Mustafa Kruja i propozoi Qazim Koculit dhe Avni Rustemit nga “Partia Popullore”, që të shuhej veprimtaria e partive politike të paktën për 6 muaj dhe të formohej një grup “demokratësh” i quajtur “Bashkimi i Shenjtë” që të përjashtonte bejlerët.⁴³ Prapa idesë së “Bashkimit të Shenjtë”, dukej se fshihej dora e qeverisë italiane. Kjo lëvizje politike synonte krijimin e një qeveri të re filoitaliane në Shqipëri. Një pjesë e deputetëve të “Partisë Popullore”, të cilët deri në këtë moment kishin

³⁹ *Po aty*, f. 205.

⁴⁰ *The National Archives*, London (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/ 5726, H. C. A. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, 22 prill 1921.

⁴¹ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 244.

⁴² *Po aty*, f. 245.

⁴³ Letër e Mustafa Krujës për Stavro Skëndin, Ramleh, (Egjipt), 2 nëntor 1953, në *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Tiranë: 1996, f. 123-124.

qëndruar jashtë manovrave politike, menduan se tashmë kishte ardhur rasti për të vepruar.⁴⁴

Si rezultat i kësaj nisme, më 9 tetor 1921 u formua një grupi i ri politik i njohur me emrin “Bashkimi i Shenjtë”. Formimi i tij shënoi fillimin e shpërbërjes së dy grupimeve politike parlamentare, grupit “popullor” dhe të grupit “përparimtar”. Në grupin e ri politik bënin pjesë 45 deputetë të dy partive kryesore politike dhe disa deputetë të pavarur, të cilët përfaqësonin rreth tre të katërtat e Parlamentit Shqiptar.⁴⁵

Më 16 tetor 1921, pas interpelancës së kërkuar nga “Bashkimi i Shenjtë”, qeveria e Iljaz Vrionit dha dorëheqjen. Pleqësia e përbërë nga Bajram Curri, Qazim Koculi, Bajram Fevziu, Avni Rustemi dhe Zija Bej Dibra u ngarkua nga të dyja palët, për të formuar qeverinë e re. Grupimi italo-fil arriti të parandalonte përfshirjen në qeveri të figurave politike më të përshtatshme, për drejtimin e vendit. Për këtë arsye, ministri Eyres shprehej se “unë mendoj se qeveria aktuale nuk do të mund të mbajë veten në pushtet për një kohë të gjatë”.⁴⁶

Qeveria e Pandeli Evangjelit u formua nga përfaqësues të dy partive kryesore politike të kohës.⁴⁷ Përveç Pandeli Evangjelit, qeveria nuk pati brenda saj, “asnjë burrë të shquar dhe me përvojë në administratë”.⁴⁸ Ministri britanik Eyres arrinte në përfundimin se “kam arsye të besoj se zëvendësimi i qeverisë së Iljaz Vrionit me qeverinë e P. Evangjelit ishte lëvizje e filluar nga partia italofile dhe e mbështetur nga ministri i Italisë në Shqipëri, për të siguruar një qeveri në favor të politikës italiane”.⁴⁹

⁴⁴ TNA, FO 371/ 5732. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 19 tetor 1921.

⁴⁵ AQSH, F. 35, V. 1921, D. 36/6, fl. 1267-1270. Letër e Seit Kemal drejtuar Mid’hat Frashërit, 20 tetor 1921; Hysen Kordha, “Ngjarjet e dhjetorit 1921”, në *Studime historike*, nr. 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti Historisë, Tiranë: 1974, f. 43.

⁴⁶ TNA, FO 371/ 5732. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 19 tetor 1921.

⁴⁷ *Po aty*, FO 371/ 5732. Telegram i H. C. A. Eyres për Foreign Office, Durrës, 19 tetor 1921; “Reth dorëheqjes së Qeverisë”, në *Shqipëri’ e Re*, nr. 53, Konstancë, 6 nëntor 1921, f. 2.

⁴⁸ TNA, FO 371/ 5732. “New Government”, në *The Near East*, London, October 7, 1921.

⁴⁹ *Po aty*, FO 371/ 5732. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 19 tetor 1921.

Në pamje të jashtme, qeveria e P. Evangjelit dukej normale, por në të vërtetë brenda saj fshihej një krizë që kishte lindur që në fillimet e saj. Formimi i këtij koalicioni politik i dha një goditje sistemit parlamentar, pasi çështjet politike filluan të zgjidheshin jashtë parlamentit. Ndërprerja e punimeve të Këshillit Kombëtar deri më 4 janar 1922⁵⁰, ishte një akt tjetër që goditi themelet e parlamentit dhe të unitetit të brendshëm politik. Krijimi i qeverisë së “Bashkimit të Shenjtë” u formua mbi themele të kalbura, prandaj ajo i komplikoi punët edhe më keq dhe çoi vendin në krizën e rëndë qeveritare të dhjetorit të vitit 1921.⁵¹

Hasan Prishtina dhe Bajram Curri nuk hoqën dorë nga synimet e tyre politike. Ata mendonin se bashkimi i Kosovës me shtetin shqiptar do të rriste numrin e popullsisë shqiptare me rreth një milion banorë.⁵² Ata dolën kundër politikës së përmbajtur e realiste të qeverive shqiptare të kohës dhe kaluan në konflikt të hapur me to, duke u bërë pjesë e rëndësishme e grushteve të shtetit dhe e kryengritjeve të armatosura antiqeveritare, të cilat ishin mjaft të rrezikshme për stabilitetin dhe ekzistencën e shtetit shqiptar.⁵³

Më 5 dhjetor 1921, në qeverinë e drejtuar nga Kryeministri P. Evangjeli mbeti vetëm Bajram Fevziu, ministri i Punëve të Brendshme. Kjo ndodhi për shkak se Aqif Pashë Elbasani u kërkoi ministrave të tjerë që të tërhiqeshin nga kjo qeveri. Më 6 dhjetor, P. Evangjeli i paraqiti Këshillit të Naltë kandidaturat e tjera për postet e ministrave, por ato nuk u pranuan nga Këshilli i Naltë me argumentin se ata nuk gëzonin besimin e popullit.⁵⁴

Për më tepër, Aqif Pashë Elbasani nxiti një grup të armatosur, të përbërë nga Mustafa Kruja, Hasan Prishtina, Ramiz Daci, Irfan Ohri dhe Riza Dani, të cilët natën ndërmjet datës 6 dhe 7 dhjetor 1921, hynë me forcë në hotelin “Internacional” ku rrinte kryeministri. Në rrethanat e një

⁵⁰ *AQSH*, F. 422, V. 1921, D. 17, fl. 61. Dekret i nënshkruar nga Aqif Pashë Elbasani, Luigj Bumçi dhe Abdi Bej Toptani, 4 nëntor 1921.

⁵¹ Letër e Mustafa Krujës për Stavro Skënderin, Ramleh, (Egjipt), 2 nëntor 1953, në *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Tiranë: 1996, f. 126.

⁵² *TNA*, FO 371/ 7330. Heathcote-Smith, konsull britanik në detyrë, për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 10 janar 1922.

⁵³ Beqir Meta, “Procesi i ndërtimit kombëtar në vitet 1920-1930”, në *100 vjet Pavarësi: Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare*, mbajtur në Tiranë, më 26-27 nëntor 2012, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet albanologjike, 2014, f. 16.

⁵⁴ *TNA*, FO 371/ 5735. Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 12 dhjetor 1921.

grushti shteti, Pandeli Evangjeli u detyrua të jepte dorëheqjen dhe u largua nga Tirana.⁵⁵

Më 8 dhjetor 1921, me kërkesën e Aqif Pashë Elbasanit, Hasan Prishtina shpalli formimin e qeverisë së re nën drejtimin e tij.⁵⁶ Diplomati britanik Heathcote-Smith njoftonte Foreign Office se “ndryshimi i qeverisë së Pandeli Evangjelit ishte në natyrën e një “*coup d’etat*”, i organizuar nga Këshilli i Regjencës nën drejtimin e Aqif Pashë Elbasanit”. Ai shprehej se ngjarjet e fundit nxorën në dritë dy aspekte të rëndësishme: qeveria e Hasan Prishtinës ishte “serbofobe”, pasi në përbërjen e saj kishte dy ministra me origjinë nga vilajeti i Shkupit. Përmbysja me forcë e qeverisë së Pandeli Evangjelit, dukej si një manovër e nxitur nga ministri italian në Shqipëri.⁵⁷

Sipas pohimeve të diplomatëve britanikë, qeveria e Hasan Prishtinës synonte të godiste “Klikën” me në krye Ahmet Zogun, ta shkatërronte këtë organizatë “të rrezikshme” dhe të dëbonte drejtuesit e saj jashtë vendit. Më tej, ai do të merrej me organizimin e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, e cila do t’i jepte formë definitive mënyrës së qeverisjes së vendit.⁵⁸

Formimi i qeverisë së drejtuar nga Hasan Prishtina shkaktoi shqetësim të madh në Beograd. Drejtuesit e shtetit jugosllav shpreheshin se marrja e pushtetit nga ana e Hasan Prishtinës dhe e Bajram Currit, do të përkeqësonte marrëdhëniet midis dy shteteve. Ata deklarorin se Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene nuk do t’i njihte Italisë të drejtën për të patur një pozitë të veçantë në Shqipëri, pa siguruar që edhe shteti jugosllav të kishte të njëjtën pozitë në Shqipëri.⁵⁹

Duke parë se po tronditeshin themelet e tij politike, Ahmet Zogu u nis nga Mirdita në drejtim të Tiranës, në krye të një force të madhe

⁵⁵ *Po aty*, FO 371/ 5735. Telegram i Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 12 dhjetor 1921.

⁵⁶ *Hasan Prishtina – Përmbledhje dokumentesh...*, dok. nr. 73, f. 115-116. Urdhri i parë i qeverisë së Hasan Prishtinës drejtuar prefekturave e nënprefekturave të Shqipërisë, Tiranë, 8 dhjetor 1921.

⁵⁷ *TNA*, FO 371/ 5735. Telegram i Heathcote-Smith për Foreign Office, Durrës, 8 dhjetor 1921; *po aty*, FO 371/ 5735. Shënime të Harold Nicolson në protokollin e Foreign Office, 13 dhjetor 1921.

⁵⁸ *Po aty*, FO 371/ 5735. Telegram i Heathcote-Smith për Foreign Office, Durrës, 8 dhjetor 1921.

⁵⁹ *Po aty*, FO 371/ 5735. Sir A. Young për markezin Curzon të Kedleston, Beograd, 15 dhjetor 1921.

ushtarake, të përbërë nga trupa qeveritare, matjanë dhe mirditorë. Hasan Prishtina i kërkoi ndihmë Bajram Currit, por ky i fundit iu përgjigj se e kishte të pamundur të braktiste mbrojtjen e kufijve në veri të vendit. Në këto kushte, Hasan Prishtina i mbetur me një numër të vogël mbështetësish, u detyrua të jepte dorëheqje nga drejtimi i qeverisë më 11 dhjetor 1921 si dhe u largua nga Tirana 24 orë para mbërritjes së forcave të drejtuara nga Ahmet Zogu.⁶⁰

Më 22 dhjetor 1921, parlamenti i kontrolluar nga Ahmet Zogu, i konsideroi të parregullta zgjedhjet e zhvilluara në prefekturën e Drinit si dhe vendosi përjashtimin nga parlamenti të deputetëve të kësaj zone, duke i akuzuar se kishin gisht në grushtin e shtetit dhe shpalli mbajtjen e zgjedhjeve të reja për këtë zonë.⁶¹ Anullimi i zgjedhjeve të zonës së Drinit ishte një kryevepër në aspektin e strategjisë politike të ndjekur nga A. Zogu. Me një goditje të vetme, ai u hoqi mandatin si deputetë, të gjithë kundërshtarëve të tij politikë.⁶²

Parlamenti dhe Gjykata e Lartë e ngritur posaçërisht, akuzoi qeverinë e Pandeli Evangjelit për mosveprim, qeverinë e Qazim Koculit se kishte vepruar në mënyrë të paligjshme, ndërsa qeverinë e Hasan Prishtinës se kishte ushtruar dhunë ndaj kundërshtarëve politikë. Parlamenti e konsideroi të paligjshme qeverinë e Hasan Prishtinës. Më 24 dhjetor 1921, parlamenti emëroi Xhafer Ypin në detyrën e kryeministrit, anëtar i “Klikës” dhe një nga mbështetësit kryesorë të Ahmet Zogut.⁶³ Parlamenti arriti në përfundimin se në krye të veprimeve të paligjshme, qëndronte Aqif Pashë Elbasani, i cili në kundërshtim me ligjin, nuk pranoi të nënshkruante dekretet për emërimin e ministrave të paraqitur nga Kryeministri P. Evangjeli. Për ngjarjet e vështira që kaloi vendi, parlamenti konsideroi përgjegjës dy anëtarët e Këshillit të Naltë, Aqif Pashë Elbasanin dhe monsinjor Luigj Bumçin.⁶⁴

⁶⁰ *Po aty*, FO 371/ 7330. Heathcote-Smith, konsull britanik në detyrë, për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 10 janar 1922.

⁶¹ *AQSH*, F. 146, V. 1921, D. 2, fl. 309-310. Protestë e deputetëve të Drinit drejtuar Kryeministrit, Tiranë, 22 dhjetor 1921.

⁶² *TNA*, FO 371/ 7330. C. Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 18 janar 1922.

⁶³ *AQSH*, F. 152, V. 1921, D. 35, fl. 1. Vendim i Këshillit të Ministrave drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Tiranë, 30 dhjetor 1921.

⁶⁴ *TNA*, FO 371/ 5736. Telegram i Heathcote-Smith për Foreign Office, Durrës, 23 dhjetor 1921.

Zhvillimet politike që ndodhën në Shqipëri gjatë viteve 1920-1921, dëshmuar se nacionalistët shqiptarë ende nuk kishin kuptuar se, nëse dëshironin që Shqipëria të qeverisej mbi baza demokratike, ata duhej të hiqnin dorë nga rivaliteti i ashpër personal, të forconin konkurrencën e mendimit si dhe përpjekjet e përbashkëta për zhvillimin e vendit mbi baza paqësore.⁶⁵

⁶⁵ *Po aty*, FO 371/ 5736. Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 12 dhjetor 1921.